



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu



-III- Nr. i prot. 1772 Më 04.06.2018
Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC

Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Rahovec Municipal Assembly



Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale me nr. 03/L-040 neni 5, Ligjin për dhënien në shfrytëzim të pronës së pa luajtshme të Komunës Nr.04/L-144, në Rregulloren QRK Nr.23/2013 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, nenit 4 të Statusit të Komunës së Rahovecit me nr.0-530 të dates:04.04.2017, Vendimi i Kuvendit komunal të Rahovecit Nr.1508 i dates:30.04.2018, Vendimit nga Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal (MAPL) me Nr.020-519 të datës: 04.05.2018 mbi ligjshmërinë e Vendimit të Kuvendit komunal me nr.1508.date: 30.04.2018, Komisioni i formuar me vendim të Kryetarit për dhënien në shfrytëzim të pronës së pa luajtshme të komunës me nr.595 të datës 16.02.2018 shpall këtë:

NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK

PËR DHËNEN E PRONËS SË PA LUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR

Ftohen të gjithë personat fizik dhe juridik, bizneset vendore dhe ndërkombëtare, kooperativat bujqësore, shoqatat bujqësore etj, që janë të interesuara për shfrytëzimin e pronës së pa luajtshme të komunës së Rahovecit që të aplikojnë në ankandin publik të shpallur me datë: 23.05.2018.

-Njoftimi publik për dhënien e pronës së pa luajtshme në pronësi të komunës përmban si në vijim:

1.Parcela kadastrale me certifikatë të pronësisë P-71510033-01039-0, parcela kadastrale me certifikatë të pronësisë P-71510033-01040-0,dhe parcela kadastrale me certifikatë të pronësisë P-71510033-01042-0,P.Sh e Kosovës, K.K.Rahovec ,në sipërfaqe të përgjithshme prej 9839 m²,në shfrytëzim do të jepet sipërfaqja përkatësisht objekti në sipërfaqe prej 2172 m², në fshatin Xërxe, (ish depot e matreksit, rezervat shtetërore)

Objekti është i destinuar për qendër grumbulluese për pemë dhe perime.

1.Afati i dhënies në shfrytëzim:

Dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme të Komunës (objektit) ,do të jepet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite.

2.Çmimi:

Dhënia e pronës së pa luajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër (objekti) është pa interes .

-Vendimi i Kuvendit komunal nr.1508, të datës 30.04.2018.

3.Veprimtaria që ushtrohet sipas destinimit të pronës:

1.Dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së pa luajtshme të komunës (Objektit) në afat prej pesëmbëdhjetë (15) vite.

2.Sipërfaqja e dhënies në shfrytëzim është 2172 m², përfshirë infrastrukturën përcjellëse si uji, rryma, kanalizimi, qasja në rrugë etj.

3.Objekti i ofruar për shfrytëzim është i destinuar për qendër grumbulluese për pemë dhe perime.

4.Lista e pajisjeve të ofruara të qendrës grumbulluese sipas listës së pranimit(aneksi 1.lista e pajisjeve)

5.Përfitimi financiar i komunës, kompensimi i sigurimit të objektit nga rojtarët.

6. Investimet e planifikuara:

6.1. Investimet në ruajtjen e prodhimeve të freskëta.

6.2.Investimi në përpunimin (ndarjen kubike dhe përgjysmë, ngrirja e tyre) e prodhimeve bujqësore të freskëta duke rritur vlerën e tyre.

6.3.Investimi në linjat e klasifikimit të pemëve dhe perimeve.

6.4.Investime në sigurimin e ambalazhimit të prodhimeve bujqësore për fermerët e komunës së Rahovecit.

6.5.Investime në paketimin e prodhimeve bujqësore sipas standardeve të cilësisë.

6.6. Zbatimi i standardeve të sigurimit të ushqimit (ISO 22000/HACCP) – e preferuar;

6.7. Me rastin e aplikimit në ankand publik, ofertuesi duhet të dëshmojë kapacitetet e kompanisë që të menaxhojë qendrën grumbulluese, kontratat me fermerët (me theks të veçantë me fermerët e komunës së Rahovecit), Kontratat me blerësit potencial (përpunuesit), kontratat me kompanitë për export si dhe bashkëpunimin eventual me komunën e Rahovecit në të kaluarën, lista e projekteve të realizuara me donator të ndryshëm dhe përfitimet e fermerëve të komunës së Rahovecit, etj.

6.8. Me rastin e aplikimit në ankand publik, ofertuesi duhet të dorëzojë projektin e detajuar duke përfshirë planin dinamik të zbatimit të projektit dhe të investimeve. Në projekt duhet të përcaktohet vlera investive;

6.9. Numri i vendeve të punës, preferohet të punësohen femra (përparësi duhet të kenë gratë të cilat janë trajnuar të punojnë në qendrën grumbulluese) dhe përfaqësues të komunitetit. Numri i vendeve të punës të specifikohet në punësimet direkte (afatgjate) dhe indirekte sezonale-afatshkurtër).

4. Dokumentet e nevojshme për aplikim:

1. Certifikata e biznesit.

2. Certifikata e numrit fiskal.

3. Numri i TVSH.

4. Vërtetimi i ATK-së që nuk ka obligime.

5. Dëshmi nga Gjykata :

5.1.Për personat juridik- dëshmi nga Gjykata që biznesi nuk ka falimentuar ose insolvent gjatë dy viteve të fundit dhe ndaj të njëjtit nuk është iniciuar procedura e likuidimit apo falimentimit

5.2.Për personat fizik dëshmi nga Gjykata që nuk është nën hetime.

6. Xhirollogaria aktive.

7. Kopja e letërnjoftimit.

5. Afati për aplikim

5.1. Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik për dhënien e pronës së pa luajtshme të komunës është tridhjetë (30) ditë nga dita e publikimit në ueb-faqen e Komunës, në vendet publike, elektronike dhe të shkruara.

5.2.Ofertat dorëzohen në zarfe të mbyllura në zyrën e prokurimit në Rahovec, nga data: **01.06.2018** deri me datë: **01.07.2018**, nga ora 09:00 deri në 16:00.

6.Vendi dhe koha e hapjes së ofertave.

Hapja e ofertave do të bëhet në sallën e Kuvendit komunal në Rahovec ,me datë **02.07.2018**, duke filluar nga ora 13:30, hapja e ofertave do të jetë transparente ,në prani të ofertuesve .

7.Kushtet apo kufizimet mbi dhënien e të drejtave për shfrytëzim

-Prona nuk mund të përdoret për qëllime tjera përpos siç është përcaktuar me ankand publik dhe i njëjti nuk mund të bartet në personin e tretë.

8. Pjesëmarrësve në konkurrim iu garantohet e drejta që të:

8.1. Informohen lidhur me procedurat e ankandit publik

8.2. Shohin pronën që do të jepet në shfrytëzim

8.3. Të kenë qasje në dokumentacionet e objektit

8.4. Të tërhiqen nga ankandi jo më vonë se tre (3) ditë para hapjes së ofertave.

8.5.Fituesi duhet të nënshkruaj regjistrin e procedurës së ankandit publik, nëse informatat e dhëna nga ofertuesi dëshmohen si të pa sakta, komisioni ka të drejtën që të refuzojë dhënien e pronës në shfrytëzim.

9. Raporti i vlerësimit të ofertave dhe procedura e nënshkrimit të kontratës

9.1 Komisioni vlerësues brenda tre(3) ditë pune nga përfundimi i vlerësimit të ofertave në ankand publik, harton raportin përfundimtar për mbylljen e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së pa luajtshme të Komunës.

9.2. Raporti përfundimtar i komisionit vlerësues të ofertave të ankandit publik përmban:

9.1. Një kopje të shpalljes së ankandit publik.

9.2. Procesverbalin e procesit të ankandit publik.

9.3. Rekomandimin e komisionit për zgjedhjen e fituesit.

9.4. Një kopje të protokolluar të ofertës së përzgjedhur.

9.5. Ankesat e parashtruara nga pjesëmarrësit në ankand publik

9.6. Pas përzgjedhjes së ofertës nga komisioni vlerësues, njoftimi i dërgohet fituesit dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen e komunës, ofertuesi me kriteret e përcaktuara më lartë do të zgjidhet fitues i ankandit publik.

9.7. Pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë komisionit për vlerësimin e ankesave në afat prej pesëmbëdhjetë (15) dite.

9.8. Nëse Komisioni për vlerësimin e ankesave konstaton se ka pasur shkelje gjatë procesit të vlerësimit, komisioni ka të drejtë të kërkoj rishqyrtimin e procesit, nëse komisioni vlerëson se nuk ka bazë, atëher ankesën e refuzon si të pa bazë.

9.9. Kontrata nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe fituesi i ankandit publik, pesëmbëdhjetë (15) ditë pune nga data e miratimit të ofertës nga ana e komisionit vlerësues.

Vërejtje: Tërheqja e aplikacioneve për konkurrim në ankand publik bëhet në formë fizike në zyrën e prokurimit në Rahovec, objekti i ri, kati I.

Rahovec,

Komisioni vlerësues i ofertave